

UDHËZIM
Nr. 10, datë 20.6.2014

**PËR PROCEDURAT, KRITERET E PËRFITIMIT TË HUAS, SHLYERJES SË
DETYRIMEVE DHE MËNYRA E ADMINISTRIMIT TË FONDIT KUNDËRPARTI,
TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe vendimit nr. 374, datë 11.06.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë”,

UDHËZOJMË:

1. TË PËRGJITHSHME

1.1 Fondet kundërparti, të krijuara nga arkëtimet prej subjekteve që kanë përfituar nga projekti i Qeverisë Japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), në shumën 130.517.500 (njëqind e tridhjetë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, të trajtohen si të ardhura jashtë limiti dhe të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit, brenda vitit 2014.

1.2 Fondet kundërparti të përdoren për financimin e projekteve investuese në bujqësi apo agroindustri, në formën e huave pa interes me kohëzgjatje 7-vjeçare, ku viti i parë është periudhë “Pa paguar”, me qëllim nxitjen, rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral dhe përpunimit të këtyre produkteve.

1.3 Përkufizime. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këtë kuptimin:

1.3.1 “Fondet kundërparti (Fondi)”, është fondi total prej 130.517.500 (njëqind e tridhjetë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, të miratuar nga Qeveria Shqiptare, që të përdoren nga AZHBR-ja në formën e huas pa interes.

1.3.2 “Komisioni i Vlerësimit dhe i Miratimit (Komisioni)” është struktura më e lartë vendimmarrëse, përgjegjëse për vlerësimin dhe miratim e huas, pa interes për projektet të cilat financohen.

1.3.3 “Sekretariati” është struktura e AZHBR-së, e ngritur me urdhër të drejtorit të AZHBR-së, i cili kontrollon përputhshmërinë nga ana formale e dokumentacionit të subjekteve aplikuese, sipas formularit të dorëzimit të dokumentacionit.

1.3.4 “Hua” është shuma e miratuar për financimin e projekteve investuese në formën e kredisë pa interes për çdo subjekt përfitues.

1.3.5 “Disbursim” është livrimi i huas në llogaritë e subjekteve përfituese.

1.3.6 “Subjekti përfitues” është subjekti për të cilin Komisioni ka miratuar dhënien e huas dhe me të cilin lidhet kontrata e huas.

1.3.7 “Këst” është shuma e përcaktuar që subjekti duhet të paguajë për kthimin e huas, në intervale kohore të përcaktuara në grafikun e kontratës.

1.3.8 “Pa paguar” është periudha gjatë së cilës subjekti përfitues, në bazë të kushteve të kontratës, nuk paguan këste.

1.3.9 “Formular” dhe “Kontratat tip huaje dhe hipoteke”, janë pjesë integrale e këtij udhëzimi.

2. STRUKTURA MENAXHUESE DHE ADMINISTRIIMI I FONDIT KUNDËRPARTI

2.1 Komisioni i Vlerësimit dhe i Miratimit është përgjegjës për vlerësimin dhe miratimin e projekteve. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si vijon:

- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU);
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Financës;
- 3 (tre) përfaqësues nga AZHBR-ja.

2.2 Kryetari dhe anëtarët e komisionit emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me propozim me shkrim nga institucioni përkatës. Kryetari i Komisionit emërohet nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave me propozim të titullarit të AZHBR-së.

2.3 Mbledhja e Komisionit zhvillohet sa herë të jetë e nevojshme për të kryer vlerësimin e projekteve investuese dhe shpalljen e subjekteve përfitues. Vendimet konsiderohen të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë të paktën 3 anëtarë. Vendimet e Komisionit merren me shumicë të thjeshtë votash dhe në rastet e votave të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.

2.4 Agjencia zbatuese, AZHBR-ja, është struktura ekzekutive e fondit kundërparti, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e tij. Konkretisht, AZHBR-ja është përgjegjëse për:

2.4.1 Informimin e aplikuesve të mundshëm, mbi kërkesat dhe procedurat për përfitimin e financimit;

2.4.2 Pranimin e aplikimeve dhe dokumenteve nga aplikantët, si dhe dorëzimin e tyre pranë Komisionit për vlerësim;

2.4.3 Kryerjen e shërbimit të sekretariatit të Komisionit të Vlerësimit dhe Miratimit, përfshirë përgatitjen, regjistrimin dhe administrimin e gjithë dokumentacionit zyrtar të veprimtarisë së këtij Komisioni;

2.4.4 Komunikimin zyrtar me vlerësuesit e pasurive, ekspertëve të licencuar dhe të miratuar, për përgatitjen e raporteve të vlerësimit për pasuritë që ofrohen si kolateral kur subjekti shpallet fitues;

2.4.5 Llogaritjen e vlerës së kështit dhe intervalet e pagesës së tij bazuar në kohëzgjatjen e huas, duke konsideruar 1 (një) vit periudhë “pa paguar” nga data e disbursimit të fundit;

2.4.6 Kontrollin e pagesës së kësteve nga çdo subjekt përfitues dhe llogaritjen e kamatës vonesave përkatëse;

2.4.7 Hartimin e nënshkrimit të kontratës së huas dhe kontratës së hipotekës/pengut midis AZHBR-së dhe subjekteve përfituese, në përputhje me kushtet e miratuara nga Komisioni. Kontrata firmoset nga drejtori i AZHBR-së dhe aplikanti i shpallur fitues;

2.4.8 Përgatitjen e dokumentacionit për vendosjen e barrës siguruese/hipotekës mbi pasurinë/pasuritë që do të shërbejnë si kolateral, dhe ndjek realizimin e këtij procesi me zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP) dhe Regjistrin e Barrës Siguruese (RBS);

2.4.9 Njoftimin e subjekteve përfituese për kostot e aplikimit deri në livrimin e fondit, të cilat mbulohen nga aplikanti (të gjitha detyrimet që lindin nga vlerësimi i pasurisë/pasurive, noterizimi i kontratave, si dhe nga akti i bllokimit në hipotekë dhe regjistri i barrës siguruese);

2.4.10 Kryerjen e disbursimit të huas në përputhje me kushtet e kontratës së huas;

2.4.11 Administrimin e fondit, mbajtjen e llogarive dhe të dhënave për çdo projekt të financuar, dhe përgatitjen e raporteve të nevojshme;

2.4.12 Ndjekjen e ecurisë së projekteve dhe pagesave të kësteve sipas skeduleve të miratuara, dhe mbajtjen e dokumentacionit në lidhje me pagesat e kësteve;

2.4.13 Monitorimin e zbatimit të projekteve sipas biznesplanit të paraqitur;

2.4.14 Ndjekjen e të gjitha procedurave gjyqësore dhe administrative për ekzekutimin e kolateraleve për subjektet që nuk kryejnë pagesën e huas sipas kushteve të kontratës.

3. KRITERET E PËRFITIMIT

Përfitojnë subjektet fizike/juridike që përmbushin kriteret e mëposhtme:

3.1 Ushtrjnë aktivitet në një nga fushat përcaktuara, si dhe paraqesin projektinvestimin në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 374, datë 11.06.2014 “Për miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë”;

3.2 Ofrojnë garanci pasurore (kolateral) për garantimin e kredisë. Si koletarale të pranueshme konsiderohen pasuri të paluajtshme: tokë truall, ndërtesa, linjat prodhimi/përpunimi, garanci

bankare me kohëzgjatje të njëjtë me atë të huas;

3.3 Vlera e kolateralit të ofruar nuk duhet të jetë më pak se 100 % (njëqind për qind) e vlerës së financuar nga AZHBR-ja;

3.4 Nuk kanë detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore, ish-projekti 2-KR/AZHBR, si dhe institucioneve të tjera huadhënëse;

3.5 Garanton, nëpërmjet një vetëdeklarimi, se huaja e marrë nuk do të ndryshojë destinacionin e përfitimit.(formulari nr. 2).

4. FUSHAT E INVESTIMIT DHE SHKALLA E FINANCIMIT

Në varësi të llojit të investimit, shkalla e financimit për subjektet përfituese do të jetë si më poshtë:

4.1 Ndërtim/rikonstruktion të stallave, pularive apo modernizim të komplekseve blegtorale dhe instalimin e impianteve të tyre ndihmëse deri në 70% të vlerës së përlogaritur të investimit, por jo më shumë se 25.000.000 (njëzet e pesë milionë) lekë;

4.2 Ndërtim/rikonstruktion (përfshirë edhe serra), blerje dhe instalim të linjave për ruajtje, përpunim dhe ambalazhim të produkteve bujqësore deri në 80% të vlerës së përlogaritur të investimit, por jo më shumë se 25.000.000(njëzet e pesë milionë) lekë.

5. APLIKIMI PËR FINANCIM

4.1 Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten në AZHBR, në Drejtorinë Qendrore, Tiranë brenda 15-ditëshit të parë të muajit korrik. Kërkesa për financim, (formulari nr. 1) dhe dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të AZHBR-së. Zyra e protokollit pajis subjektin aplikues me një kopje të protokolluar të formularit të aplikimit (formulari nr. 3) dhe listën për dokumentacionin e dorëzuar. Zyra e protokollit i dorëzon Sekretariatit dosjet e aplikantëve Sekretariatit.

4.2 Sekretariati, i ngritur me urdher të drejtorit të AZHBR-së, brenda 5 (pesë) ditëve nga afati përfundimtar i aplikimit, përcjell dosjet tek Komisioni i Vlerësimit dhe i Miratimit. Pjesë e dokumentacionit është edhe lista emërore e subjekteve, aplikimet e të cilëve nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar, duke specifikuar mangësitë e konstatuara (formulari nr. 4).

4.3 Procesi i vlerësimit të projekteve nga Komisioni i Vlerësimit dhe Miratimit, përfundon brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të dosjeve nga sekretariati. Komisioni mund të kërkojë informacion dhe dokumente shtesë nëse e shikon të nevojshme, me qëllim shqyrtimin sa më të drejtë të aplikimit. Paraqitja e dokumentacionit shtesë bëhet me qëllim që të rikonfirmohet dokumentacioni ekzistues brenda 5 ditëve pune, ky dokumentacion nuk duhet të ndryshojë statusin aktual të dosjes.

4.4 Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, komisioni i përcjell AZHBR-së, listën e fituesve, procesverbalin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të dokumentacionit dhe listën e subjekteve të kualifikuara dhe të skualifikuara(formulari nr. 5 dhe formulari nr. 6).

4.5 Ankesat e aplikantëve paraqiten pranë AZHBR-së brenda 10 ditëve pas shpalljes së listës së fituesve. Drejtori i AZHBR-së pas marrjes së ankimeve, krijon një komision të ndryshëm nga i pari, brenda strukturave të AZHBR-së i cili shqyrton ankesën-kërkesën. Komisioni përbëhet nga 3 zyrtarë të AZHBR-së, ndjek dhe zbaton detyrimet sipas udhëzimit, administron proces-verbalin mbi procedurën e ndjekur të ankimit. Në përfundim njofton "Titullarin" mbi vendimin e marrë.

5. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

5.1 Dokumentacioni ligjor:

Person juridik/fizik/shoqëria e bashkëpunimit bujqësor (SHBB);

5.1.1 Fotokopje e kartës së identitetit ose e pasaportës së personit fizik ose përfaqësuesit ligjor të personit juridik;

5.1.2 Ekstraktin historik të personit fizik/personit juridik, SHBB të lëshuar nga QKR-ja jo më parë se 30 ditë nga dita e aplikimit;

5.1.3 Kopje të statutit të shoqërisë, nëse subjekti është person juridik/SHBB;

5.1.4 Vendimi i asamblesë së ortakëve për marrjen e huas pranë AZHBR, nëse subjekti është person juridik ose SHBB;

5.1.5 Dëshmi penaliteti për aplikantin apo përfaqësuesin e personit juridik/fizik apo të përfaqësuesin e SHBB-së;

5.1.6 Të gjitha dokumentacionet dhe lejet përkatëse (leje ndërtimi, leja e QKL,etj.) në varësi të llojit të investimit, sipas legjislacionit në fuqi.

5.2 Dokumentacioni financiar lidhur me planin e investimit

5.2.1 Pasqyrat financiare të 3(tre) viteve paraardhëse, kopje të njehsuar nga organet tatimore (për bizneset që kanë ushtruar aktivitet gjatë kësaj periudhe). Për aktivitetet që janë start-up, (për herë të parë) vërtetim nga organet tatimore;

5.2.2 Vërtetim nga zyra e tatimeve që nuk ka detyrime tatimore;

5.2.3 Plani i biznesit i detajuar me pasqyrat e *cash flow*, i firmosur për të paktën 3(tre) vjet;

5.2.4 Oferta/ofertë për blerjen e pajisje-makinerive etj. marrëveshje paraprake për blerje të pajisje-makinerive;

5.2.5 Preventivë punimesh ose kontrata për ndërtim-rikonstruksion dhe specifikimet përkatëse në varësi të llojit të investimit, si dhe licencën e inxhinierit të ndërtimit/zbatimit për punimet e ndërtimit/rikonstruksion;

5.2.6 Vërtetim për numrin e llogarisë bankare dhe IBAN;

5.2.7 Dokumenti mbi statusin e aplikantit/personit fizik/juridik/SHBB nga Regjistri i Kredisë në Bankën e Shqipërisë (në emër të personit fizik dhe në emër të personit juridik apo përfaqësuesit të SHBB).

5.3 Dokumentacioni në lidhje me kolateralin e ofruar

5.3.1 Certifikata e pronësisë /me kopjen origjinale të kartelës së pronës, me hartën treguese (për të dyja rastet të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi) ose fotokopje të noterizuar;

5.3.2 Vlerësimi i pasurisë që do të lihet si kolateral nga eksperti i licencuar dhe të miratuar, duhet të mbulojë vlerën e kredisë në masën 100% në momentin e likuidimit.

6. Kriteret e vlerësimit/pikëzimit

6.1 Biznesplani i detajuar për periudhën

për të cilën merret kredia 40 pikë;

6.2 Vlera totale e investimit sipas

aplikimit me vlerën më të madhe 20 pikë;

Statusi i aplikantit, pikët maksimale:15 pikë;

i) Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB)15 pikë;

ii) Persona fizikë ose juridikë (prodhues, tregtues apo fermerë) 10 pikë;

a) Investime në linja sa më të plota

(cikël të mbyllur) 10 pikë;

b) Eksperienca të mëparshme në këtë

fushë 10 pikë;

c) Fermer nën moshën 40 vjeç ose

gjinia femër 5 pikë.

Pikët e shprehura janë pikë maksimale dhe për aplikantët e tjerë vlerësohet proporcionalisht.

Në rastet kur aplikimi rezultojnë me pikë të barabarta, aplikohet parimi “Kush aplikon i pari, renditet i pari”.

6. DISBURSIMI I HUAS

Pas shpalljes nga Komisioni i Vlerësimit dhe Miratimit të listës së përfituesve, AZHBR-ja fillon

procedurën e nënshkrimit të kontratave të huas/hipotekimit dhe të livrimit të huave në përputhje me kushtet e miratuara. Përpara disbursimit të çdo shume, AZHBR-ja kontrollon dhe sigurohet që në dosjen e përfituesit ndodhen:

6.1 Kontratat, të cilat janë nënshkruar dhe noterizuar.

6.2 Subjekti ka hipotekuar në favor të AZHBR- së kolateralin dhe ka paraqitur certifikatën e hipotekimit të kolaralit.

6.3 Subjekti ka siguruar kolateralin (ndërtesa, linja etj.) nga rreziqet pranë një kompanie sigurimi.

6.4 Në dosjen e përfituesit ndodhen të gjitha lejet e nevojshme për kryerjen e investimit dhe ushtrimin e aktivitetit.

6.5 Subjekti ka dorëzuar numrin e llogarisë bankare ku do të depozitohet huaja.

6.6 Përpara disbursimit AZHBR-ja monitoron investimin/blerjen e makineri-pajisjeve të cilat detyrimisht duhet të jenë të realizuar në raport me masën e financimit të huas, si dhe investimit të kryer të vetë përfituesit.

6.7 Disbursimi i kredisë, për projektet që përfshijnë punimet e ndërtimit/rikonstruksion, disbursimi do të bëhet me 2 këste, në varësi të investimit, për blerje/pajisje-makineri disbursimi do të bëhet me paraqitjen e faturave me TVSH, pas kontrollit të ushtruar në vend nga struktura përkatëse e AZHBR-së.

6.8 Vendosja e barrës së dytë hipotekore do të pranohet nga komisioni i vlerësimit dhe i miratimit, vetëm në ato raste kur vlera e kolateralit që do të lihet si hipotekë sipas vlerësimit të ekspertit është jo më pak se 150% e vlerës totale të huave (të mbetur) për të cilat është vendosur prona si kolateral, duke përfshirë edhe huan e fondit kundërparti.

6.9 Për vendosjen e barrës së dytë hipotekore duhet të jepet më parë pëlqimi i hipotekuesit të radhës së parë.

6.10 Në qoftë se projekti përfundon para afatit të kontraktuar, me kërkesën zyrtare të subjektit dhe verifikimit në terren bëhet edhe disbursimi i plotë i kredisë.

7. TË TJERA

7.1 Subjekti përfitues është i detyruar të raportojë dhe të japë informacion në AZHBR, për të dhënat që kërkohen prej tij dhe mban përgjegjësi për saktësinë e tyre.

7.2 Shlyerja e kredisë të jetë me këste me një periudhë “Pa paguar” prej 1 (një) vit, që fillon nga disbursimi i fundit. Këstet do të jenë 3-mujore(tremujore) dhe kthimi i kredisë të arkëtohet në llogarinë rrjedhëse të përcaktuar nga AZHBR-ja.

7.3 Për rastet e mospagimit në kohë të këstit ose të një pjese të këstit, subjekti përfitues penalizohet me një kamatëvonesë mbi vlerën e shumës së papaguar të këstit, e llogaritur kjo për çdo ditë vonesë. Kamatëvonesa do të llogaritet nga dita që është me vonesë në pagesë. Norma vjetore e interesit për llogaritjen e shumës së kamatëvonesës do të jetë 10%.

7.4 Kur subjekti fitues nuk paguan 2 (dy) këste radhazi, të cilat janë pasqyruar në kontratë, AZHBR-së i lind e drejta t'i drejtohet organeve kompetente gjyqësore, për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

7.5 Kur përfituesi nuk plotëson kushtet e kontratës së lidhur mes palëve dhe kur përfituesi devijon qëllimin e përdorimit të kredisë, AZHBR-ja ka të drejtë të bllokojë disbursimin e kredisë së mbetur dhe të kërkojë kthimin e shumës së disbursuar, kamatëvonesat e përlllogaritura, deri në atë periudhë.

7.6 Çdo kërkesë për ndryshimin e kolateralit të vendosura si hipotekë në favor të AZHBR, do të merret në shqyrtim vetëm pasi të jenë paraqitur i gjithë dokumentacioni dhe kërkesa mbi arsyet e ndryshimit, pasi të jetë bërë vlerësimi nga ekspertët vlerësues për kolateralin e ri të ofruar në masën 100% të kredisë së marrë, si dhe të jenë shlyer këstet sipas përcaktimeve të bëra në kontratën e huas.

7.7 Drejtori i AZHBR ngre një komision prej 3 specialistësh i cili merr në shqyrtim kërkesën për ndryshime në kolaterali, ai ndjek dhe zbaton të gjitha procedurat ligjore në përputhje me legjislacionin për vendosjen e kolateralit të ri. Të gjitha shpenzimet e lidhura me këtë proces, mbulohen nga aplikantët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Edmond Panariti

MINISTRI I FINANCAVE

Shkëlqim Cani